

# Workshop me temë: “Marketingu dhe Komunikimi”

---

Sektori i Këshillimit të Karrierës dhe ALUMNI-t në bashkëpunim me Bordin Këshillimor të Biznesit zhvilloi aktivitetin e rradhës për studentët me kompaninë private ZHAN 92 me temë: “Marketingu dhe Komunikimi”.



Z. Edmond Kristo, prezantoi për studentët materialin e përgatitur duke paraqitur fillimisht një historik të shkurtër të start up-it në biznesin ZHAN 92, por edhe në fushën e medias me Televizionin Egnatia në Elbasan, duke u bërë model frymëzimi dhe motivimi për studentët e pranishëm në sallë.



Në këtë workshop u diskutua mbi pozicionimin që çdo individ duhet të marrë në jetë e sidomos theksi u vu tek rëndësia që ka komunikimi jo vetëm në ndërtimin e raporteve me të tjerët, por edhe në bërjen e marketingut më të mirë të aftësive tona apo biznesit që do të ngremë në të ardhmen